



## Këshilli i Sigurimit

Distr.: e përgjithshme  
12 prill 2022

Perkthim: Shqip

---

### Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

#### Raport i Sekretarit të Përgjithshëm

##### I. Hyrje dhe prioritetet e misionit

1. Ky raport dorëzohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli themeloi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm që të raportoj në intervale të rregullta për zbatimin e mandatit të tij. Në raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 shtator 2021 deri më 15 mars 2022.

2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe respektit për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe në regjion. Në çuarjen përpara të këtyre qëllimeve, UNMIK-u vazhdon angazhimin e tij konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë dhe me palët regjionale e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me përmeshjen e roleve të tyre në kuadër të Rezolutës 1244 (1999). Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë vazhdon praninë e tij në Kosovë, në përputhje me deklaratën e Kryetarit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), dhe me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara kanë bashkëpunim të ngushtë me Misionin.

3. Më 16 janar 2022, Përfaqësuesja e re Speciale e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Shefja e UNMIK-ut, Caroline Ziaeh, arriti në Prishtinë dhe mori udhëheqjen e Misionit.

##### II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

4. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë gjatë periudhës raportuese u fokusuan rreth organizimit të zgjedhjeve lokale në Kosovë; tensioneve mes Prishtinës dhe Beogradit lidhur me aspektet e lirisë së lëvizjes; mbajtjes së referendumit

kushtetues të Serbisë në Kosovë më 16 janar 2022 dhe rreth zgjedhjeve parlamentare e presidenciale të Serbisë në Kosovë. Bashkimi Evropian intensifikoi përpjekjet për avancimin e dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, me përkrahjen e rritur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe palëve evropiane.

5. Më 17 tetor 2021, u mbajtën zgjedhjet komunale në të gjitha 38 komunat e Kosovës, të cilat u pasuan me zgjedhjet e balotazhit në 21 komuna që u mbajtën më 14 nëntor. Në këto zgjedhje gjithsej morën pjesë 89 subjekte politike, nga të cilat 32 ishin parti politike. Dalja e zgjedhësve arriti shkallën prej 42.5 për qind, ndërsa procesin e përcollën 24.693 vëzhgues të akredituar. Gara zgjedhore u zhvillua për gjithsej 166 pozita të kryetarëve të komunave dhe 5.199 pozita të asambleistëve komunalë. Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës fituan 8 komuna secila, të pasuara nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës që fitoi pesë komuna dhe Lëvizja Vetëvendosje me katër, ndërsa Nisma Socialdemokrate, Partia Demokratike Turke e Kosovës dhe Nisma Qytetare Obiliqi fituan nga një komunë. Lista Serbe fitoi të gjitha 10 komunat e Kosovës me shumicë serbe. Lidhur me përfaqësimin e femrave, 14 gra apo 8,3 për qind e të gjithë kandidatëve garuan në këtë zgjedhje që paraqet rritje krahasuar me zgjedhjet e vitit 2017, kur 3 për qind të kandidatëve ishin femra. Me këtë rast, vetëm dy femra – që të dyja përfaqësuese të Listës Serbe – fituan garën për kryetare të komunës. Kandidatet femra përfaqësuan 37.2 për qind të kandidatëve për asamblesitë në kuvendet komunale që paraqet një rritje të vogël nga 34.8 për qind, sa ishin në zgjedhjet e vitit 2017.

6. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, me mbi 100 vëzhgues të zgjedhjeve, e vlerësoi organizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve si pozitiv, duke vërejtur njëkohësisht një mungesë të caktuar transparence dhe llogaridhënieje lidhur me financimin e fushatës dhe konkurrencën e kufizuar në zgjedhje për shkak të numrit të vogël të kandidatëve në komunat me shumicë serbe.

7. Në raportin për Kosovën të datës 19 tetor 2021, Komisioni Evropian theksoi se korniza juridike zgjedhore e Kosovës në thelb ka mbetur e pandryshuar që nga viti 2010, përkundër rekomandimeve zgjedhore të misioneve të mëparshme të vëzhguesve zgjedhorë dhe ekspertëve të Bashkimit Evropian. Në përgjithësi, Komisioni vlerësoi përparimin e caktuar në vitin 2021 lidhur me avancimin në reformat e orientuara kah Bashkimi Evropian, duke theksuar njëkohësisht përparimin e ngadalshëm në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Përkitazi me reformat në sundimin e ligjit, Komisioni vuri në pah rëndësinë e përparimit në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, nevojën për rritjen e transparencës në institucionet publike dhe të zvogëlimit të ndikimit të parregullt politik në gjyqësor. Komisioni gjithashtu shprehu shqetësim lidhur me propozimin e qeverisë për rivlerësimin e plotë dhe të njëhershëm të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

8. Tensionet mes Beogradit dhe Prishtinës patën disa shkëndija në ditët para zgjedhjeve komunale që kryesisht u nxitën nga aspektet e kamotshme të pazgjdhura në zbatimin e marrëveshjes së lehtësuar nga Bashkimi Evropian për lirinë e lëvizjes. Më 20 shtator 2021, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës filloi politikën e re

për automjetet me targa të Serbisë, ku kërkohet që ato të hiqeshin në vendkalimet zyrtare dhe të zëvendësoheshin me tabela të përkohshme të Kosovës. Në zonat e populluara me serbë u ngritën kundërshtime, posaçërisht në veri, ndërsa njësitë speciale të policisë së Kosovës u vendosen afër pikëkalimeve G1 në Jarinjë dhe G 31 në Bërnjak me qëllim të zbatimit të kësaj politike. Në shenjë proteste, banorët u grumbulluan afër 2 pikëkalimeve dhe i bllokuan rrugët transite. Zyrës për regjistrimin e automjeteve në Zubon Potok iu vë flaka, ndërsa një mjet shpërthyes është gjetur në Zyrën për regjistrimin e automjeteve në Zveçan. Tensionet mes policisë së Kosovës dhe protestuesve kërcënuan të kalojnë në konfrontim fizik. Njëkohësisht me dënimet e qasjes së Kosovës, Serbia ngrii aeroplanët ushtarakë dhe ripozicionojë një forcë të vogël të reagimit të shpejtë në zonat afër kufirit administrativ. Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, i shoqëruar nga ambasadori i Federatës Ruse në Beograd, vizituan njësitë ushtarake serbe të dërguara në zonë. Përfaqësuesi Special iu bashkua Bashkimit Evropian dhe palëve të tjera ndërkombëtare në thirrjet për shtensionim dhe dialog.

9. Kundërthënia ndodhi pas vizitës së rregullt konsultative të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për çështjet e tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, Miroslav Lajčák, në Prishtinë e Beograd nga datat 15 deri më 21 shtator 2021. z. Lajčák dhe kryenegociatorët e Prishtinës dhe Beogradit më pas u takuan në Bruksel, me ç'rast palët u pajtuan që më 2 tetor 2021 njësitë speciale të policisë së Kosovës të largohen njëkohësisht me deblokimin e rrugëve, të mbikëqyrur nga KFOR-i. Palët gjithashtu u pajtuan për zbatimin e masës së përkohshme të vendosjes së letrave ngjitëse si në targat e Kosovës, ashtu edhe në ato të Serbisë. Një grup i veçantë punues, i përbërë nga të dy palët dhe përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, u themelua dhe iu dha detyra për gjetjen e zgjidhjes më afatgjatë deri më 21 prill 2022. Deri në momentin e raportimit ky grup u takua gjashtë herë, ku thuhet se ka përparime.

10. Në tetor 2021 në veri tensionet përsëri i ngritën kur policia e Kosovës u angazhua në një operacion kundër trafikimit në disa vende të Kosovës, duke përfshirë Prishtinën, Pejën, Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut dhe Zveçanin. Në dy komunat e fundit, rezistenca e serbëve ndaj praninë së policisë speciale nxiti konfrontime, me ç'rast pati lëndime të policëve, protestuesve dhe të kalimtarëve të rastit. Zyrtarët e Kosovës, në mbrojtje të operacionit, shprehën qëndrimin e pakompromis të Kosovës se “krimi dhe grupet kriminale nuk do të tolerohen dhe do të luftohen”. Kryetari i Serbisë, Vuçiq, udhëtojë në Rashkë, në veri të kufirit administrativ, ku kërkoi përmbajtje të udhëheqësve serbë të Kosovës, duke u zotuar njëkohësisht për reagim ndaj “çfarëdo tentimi të përdorimit të dhunës kundër serbëve të Kosovës”.

11. Pas njoftimit nga Serbia për mbajtjen e referendumit më 16 janar 2022 për ndryshimet në Kushtetutën e Serbisë lidhur me gjyqësorin, prapë lindën kundërshtimet rreth çështjeve të votimit në Kosovë. Në vazhden e thirrjeve nga shtetet e kuintit (Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe Bashkimi Evropian drejtuar autoriteteve të Kosovës për të lehtësuar votimin, presidentja Osmani, kryeministri Kurti dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, lëshuan një deklaratë të përbashkët, ku theksuan se “qytetarët serbë

të Kosovës me shtetësi të dyfishtë do të kenë të drejtën e votimit në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, siç është mundësia e votimit përmes postës elektronike dhe Zyrës ndërlidhëse të [Beogradit]”. Në një seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 15 janar 2022, me kërkesë të kryeministrit Kurti, ky qëndrim u konfirmua me shumicë votash. Përfaqësuesit e Listës Serbe nuk morën pjesë në seancë. Zyrtarët e Beogradit reagon fuqishëm, duke akuzuar Prishtinën se po vepron në kundërshtim me dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian.

12. Para mbajtës së referendumit të Serbisë, policia e Kosovës arrestoi punonjësit e Komisionit të Zgjedhjeve të Serbisë, të cilët tentuan që të sjellin materialet e votimit përtej vijës së kufirit administrativ. Zyra e Qeverisë së Serbisë për Kosovë deklaroi se materialet pritej të ishin në përkrahje të grumbullimit të fletëvotimeve nga OSBE-ja, siç është praktikuar edhe më parë. Misioni i OSBE-së në Kosovë paraprakisht kishte njoftuar Beogradin se një gjë e tillë do të ishte e pamundur pa pëlqimin e të gjitha palëve, duke përfshirë Prishtinën. Komisioni Zgjedhor i Serbisë pastaj deklaroi se serbët e Kosovës do të ishin në gjendje të votonin vetëm në vende të caktuara në veri të kufirit administrativ. Në ditën e referendumit, më 16 janar 2022, me përkrahje të autoriteteve të Beogradit, është organizuar transportimi i votuesve në komunat e Kosovës me shumicë serbe. Në veri të Mitrovicës është mbajtur protesta kundër qëndrimit të Prishtinës, përderisa edhe në vende të tjera të Kosovës kishte protesta më të vogla.

13. Gjatë periudhës raportuese, janë raportuar 13 incidente që kanë prekur komunitetin serb dhe vendet fetare ortodokse e kulturore serbe, duke përfshirë dëmtimet e gurëve të varreve në varrezat ortodokse serbe në komunat Prizren, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Istog, si dhe ndërtimin e paligjshëm në Zonën e posaçme të mbrojtur të Manastirit Shën Uroshi në komunën e Ferizajt. Incidentet e tjera kishin të bënin me vjedhjen e parave në vendet e konfesioneve të ndryshme fetare nëpër Kosovë, duke përfshirë vjedhjet në xhami, në varrezat myslimane dhe në kishat ortodokse serbe, si dhe dëmtimin në kishën katolike të qytetit të Pejës.

14. Gjatë periudhës së dimrit Kosova u ballafaqua me krizën e furnizimit me energji elektrike ku kishte reduktime të rregullta të rrymës si shkak i kapaciteteve të zvogëluara për plotësimin e kërkesës së lartë të energjisë gjatë sezonit. Më 29 dhjetor 2021, Kuvendi i Kosovës miratoi një numër masash të energjisë të propozuara nga qeveria, duke përfshirë kufizimet në konsumin e energjisë për një periudhë 60 ditore. Qeveria po ashtu arriti marrëveshje afatshkurtër të furnizimit me energji me Shqipërinë me qëllim të zbutjes së kufizimeve energjetike. Në fillim të shkurtit 2022, Zyra e Rregullatorit të Energjisë rriti çmimin e energjisë elektrike për amvisëritë që harxhojnë mbi një prag të caktuar të konsumit, gjë që çojë në kritika të shumta dhe në disa protesta të qytetarëve. Partitë e opozitës shprehën qëllimin e tyre për të sfiduar masat emergjente përmes padive në gjykata.

15. Autoritetet e Kosovës mbajtën mbledhje të përbashkëta me qeverinë e Shqipërisë, më 16 shtator 2021, dhe me atë të Maqedonisë së Veriut, më 26 nëntor 2021. Nga këto mbledhje dolën disa marrëveshje për avancimin e lirisë së lëvizjes,

për bashkëpunimin në fushën e energjisë, si dhe për lidhshmërinë e hekurudhave, të tregtisë dhe për lidhje në fushën e arsimit.

16. Nga data 21 deri më 22 dhjetor 2021, udhëheqësit e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë u takuan në Tiranë me qëllim të avancimit të nismës Ballkani i Hapur, të cilën Prishtina e kundërshtoi si jo në përputhje me nismën regjionale të procesit të Berlinit, të quajtur “Tregu i përbashkët regional”. Mbledhja e dhjetorit doli me pesë marrëveshje të reja që kanë për qëllim lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, bashkëpunimin ekonomik dhe qasjen në tregun e punës. Një numër shtetesh të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë mirëpritur nismën, duke theksuar njëkohësisht nevojën për avancimin e bashkëpunimit përfshirës regjional.

17. Shumica e të evakuuarve afganë të pranuar nga autoritetet e Kosovës janë rivendosur në vendet e Evropës dhe në Amerikë të Veriut, në pajtim me marrëveshjet e arritura mes vendeve evropiane, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Raportohet se përafërsisht 50 të evakuuar nga gjithsej 1000 sa ishin, ende mbesin në Kosovë.

18. Më 22 tetor 2021, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, me udhëzim të Presidentes së Kosovës, shpalli dy punonjës të Zyrës Ndërlidhëse të Rusisë në Prishtinë si “*persona non grata*”, duke deklaruar se aktivitetet e tyre “rrezikojnë sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës”. Federata Ruse protestojë ndaj këtij vendimi, duke theksuar se autoritetet e Kosovës nuk kishin bazë ligjore për ndërmarrjen e hapave të tillë. Në letërën e komunikuar më 3 nëntor 2021 kryeministrit të Kosovës, Misioni kërkoi respektimin e privilegjeve dhe imuniteteve të zyrtarëve ndërlidhës dhe punonjësve të tyre në përputhje me rregulloret relevante të UNMIK-ut, të miratuara në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, dhe me të drejtën ndërkombëtare. Këto porosi Misioni gjithashtu i ka bartur në takimin pasues me kryeministrin, më 2 dhjetor 2021.

19. Më 31 dhjetor 2021, duke cituar kërkesën e kryeministrit Kurti, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës deklaroi përmes një platforme të rrjeteve sociale, se një punonjës i UNMIK-ut do të shpallej “*persona non grata*”. Më 1 janar 2022, zëdhënësi i Sekretarit të Përgjithshëm nënvizoi se doktrina e “*persona non grata*” nuk ishte e aplikueshme ndaj punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe se çfarëdo shqetësimesh lidhur me punonjësin e UNMIK-ut duhet t’i drejtohen Misionit në përputhje me statusin, privilegjet dhe imunitetet e UNMIK-ut dhe punonjësve të tij. Më datën 2 janar 2022, UNMIK-u pranoi komunikimin e parë zyrtar nga autoritetet e Kosovës për këtë çështje. Udhëheqësia e Misionit ia shprehu autoriteteve të Kosovës pritjen që çështja të zgjidhet në përputhje me statusin, privilegjet dhe imunitetet e UNMIK-ut dhe punonjësve të tij. Në mbyllje të periudhës raportuese, përkundër ngritjes së kësaj çështjeje në disa raste, UNMIK-u nuk është njoftuar për ndonjë veprim të ndërmarrë lidhur me këtë kërkesë.

### III. Ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe reagimi ndaj saj

20. Kosova vazhdoi të jetë e prekur nga pandemia e sëmundjes së virusit korona COVID-19, duke kaluar në valën më intensive të infektiveve të reja në janar të vitit 2022. Në kulmin e saj, numri ditor i rasteve të reja u ngritë në më shumë se 4.000, ndërsa rastet aktive tejkaluan shifrën e 36.000. Deri në fund të periudhës raportuese, janë regjistruar mbi 237.000 raste të COVID-19, dhe 3.339 vdekje janë raportuar në Kosovë që nga fillimi i pandemisë.

21. Si reagim ndaj numrit të rritur të rasteve, qeveria e Kosovës vendosi kufizime të reja që filluan nga data 22 janar 2022, duke përfshirë kushtin për tri doza të vaksinimit apo dy doza dhe testin negativ të Reagimit Zinxhiror të Polimerazës (PCR) për të hyrë në Kosovë. Avokati i Popullit i Kosovës erdhi në përfundim se masa e fundit ishte disproporcionale. Kjo masë nxiti gjithashtu edhe protesta në Shqipërinë fqinje dhe thirrje për rishikim nga autoritetet shëndetësore në Maqedoninë e Veriut, pasi që u konsiderua si pengesë për lirinë e lëvizjes. Në mes të tjerash, kjo masë preku 3.500 studentë të pavaksinuar në Mitrovicë të Veriut, të cilët nuk patën mundësi të hyjnë në provimet e fundit të semestrit. Këto kufizime u hoqën më 5 shkurt 2022.

22. Gjatë periudhës raportuese, procesi i vaksinimit në Kosovë ka vazhduar, ku autoritetet shëndetësore vazhduan me administrimin e dozës së tretë të vaksinës si shtesë e dy dozave fillestare. Deri në mesin e muajit mars, 900.051 individë (rreth 50% e popullatës së gjithmbarshme) kanë marrë së paku një dozë të vaksinës, ndërsa 818.331 (rreth 45.5 për qind e popullatës së gjithmbarshme) kanë marrë dy doza, si dhe 98.630 persona kanë marrë dozën e tretë.

23. Autoritetet komunale të Kosovës vendosen ekipe lëvizëse të vaksinimit në vendet e banuara nga komunitetet joshumicë, siç është rasti në komunën e Suharekës, në qytetin e Gjakovës dhe në 16 fshatra të komunës së Prizrenit. Disa banorë, kryesisht nga komunat me shumicë serbe, morën vaksinat më herët nëpër vende të ndryshme të Serbisë. Komunitetet rome, ashkallike dhe egjiptase të Kosovës vazhduan të ballafaqohen me sfida të caktuara si rrjedhojë e efekteve socio-ekonomike të pandemisë.

24. Gjithsej numri i rasteve të COVID-19 në mesin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe vartësve të tyre që nga fillimi i pandemisë u rritë nga 202 në 351. UNMIK-u dhe agjencitë, fondet e programet e Kombeve të Bashkuara mbetën plotësisht operacionale. Përveç testimit PCR, në Mision fillojë të bëhet edhe testimi antigjen dhe u finalizuan marrëveshjet për përkrahje mjekësore me spitalet në Shkup, Maqedoni e Veriut, për të gjithë punonjësit e Kombeve të Bashkuara dhe vartësit e tyre.

25. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vazhduan të përkrahin autoritetet e Kosovës në fushatën e tyre të vaksinimit masiv që përfshiu zgjerimin e vendeve të vaksinimit dhe ofrimin e trajnimeve të specializuara të punëtorëve shëndetësorë për pandeminë COVID-19. Ata gjithashtu i përkrahen Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe

Inovacionit në sigurimin e mjediseve të sigurta për mësim me prani fizike. Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve mbështeti modernizimin e reparteve të mjekimit intensiv nëpër spitale të komunave të ndryshme.

#### **IV. Kosova veriore**

26. Afati gjashtëmujor i caktuar nga Kuvendi i Kosovës ndaj Operatorit të Kosovës për Sistemin e Energjisë Elektrike, Transmision dhe Treg për të marrë përgjegjësinë lidhur me koston e energjisë së shfrytëzuar në katër komunat e veriut të banuara me popullatë shumicë serbe ka skaduar më 6 nëntor 2021. Në mungesë të marrëveshjes për përfshirjen e këtyre komunave në sistemin e faturimit të Kosovës, Operatori ka ndarë një shumë prej 6.7 milionë euro shtesë për mbulimin e shpenzimeve deri në fund të vitit 2021. Në janar të vitit 2022, Operatori i Kosovës për Sistemin e Energjisë Elektrike, Transmision dhe Treg deklaroi se në vitin 2021 shpenzimet e bëra të energjisë elektrike ishin 40.9 milionë euro, dhe parapanë rritje të mëtejme të këtyre shpenzimeve për periudhën mes muajit janar dhe mars 2022 deri në 30 milionë euro për shkak të rritjes së çmimit të importit të energjisë elektrike.

27. Më 18 nëntor 2021, Gjykata Supreme urdhëroi rigjykimin për rastin e deputetit të Kuvendit të Kosovës nga Lista Serbe dhe ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Ivan Todosijeviq. z. Todosijeviq ishte dënua në dhjetor 2019 me dy vite burg për shkak të refuzimit të krimit të pretenduar të luftës, i cili ndodhi në fshatin Reçak në vitin 1999. Përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme u anulua vendimi i dhjetorit 2019 i Gjykatës themelore të Prishtinës dhe aktgjykimi i gushtit 2021 i Gjykatës së Apelit në bazë të mungesës së qartësisë lidhur me elementet e veprës penale. Në aktgjykim gjithashtu jepet përgjigja në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të z. Todosijeviq, të parashtruar nga mbrojtja e tij, ku kundërshtohet përbërja etnike e panelit gjykues si shkelje e Marrëveshjes së parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve të datës 19 prill 2013, të lehtësuara nga Bashkimi Evropian. Rigjykimi filloi më 11 shkurt 2022, por u pezullua në pritje të shqyrtimit të kërkesës së mbrojtjes për zhvendosjen e procedurave në Gjykatën themelore të Mitrovicës dhe për largimin e të gjithë gjyqtarëve shqiptarë nga paneli gjykues. Më 10 mars 2022, kryetari i Gjykatës Supreme refuzoi si të papranueshme kërkesën e mbrojtjes për ndryshimin e vendit dhe diskualifikimin e gjyqtarëve, dhe rigjykimi pritet të fillojë në një datë të mëvonshme.

28. Më 4 janar 2022, qeveria e Kosovës ndaloi prodhimin e kriptovalutave në kuadër të masave emergjente për trajtimin e krizës energjetike. Kjo praktikë është bërë fenomen në vende të shumta të Kosovës, duke përfshirë edhe komunat e veriut ku për shkak të problemeve të zbatimit të marrëveshjes për energji mes Beogradit dhe Prishtinës, të lehtësuara nga Bashkimi Evropian, banorët aktualisht nuk faturohen për energjinë e shpenzuar. Pas ndalesës, policia e Kosovës dhe zyrtarët doganorë ndërmorën disa operacione në vende të ndryshme, duke përfshirë edhe Kosovën veriore, dhe konfiskuan pajisjet e dyshuara për prodhimin e kriptovalutave.

29. Më 24 shkurt 2022, policia e Kosovës mbylli rrugët e qasjes në pikëkalimet jozyrtare të kufirit administrativ në komunën e Zubin Potokut dhe atë të Leposaviqit.

Pas këtij operacioni, disa fshatra raportuan vështirësi të qasjes në rrugët kryesore. Më 26 shkurt 2022, disa kamionë të përcjellë nga policia e Kosovës transportuan kontejnerë dhe pajisje të tjera në pikëkalimin Gate 31 në Bërnjak, me qëllimin e deklaruar të përmirësimit të kushteve të punës në pikëkalim. Ndaj këtyre veprimeve Beogradi protestoi, duke i cilësuar si provokime kundër komunitetit serb në Kosovë.

## **V. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit dhe Prishtinës**

30. Më 6 tetor 2021, nën patronazhin e Gjermanisë dhe Francës, kryeministri Kurti dhe presidenti Vuçiq u takuan në margjinat e samitit të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor në Bërdo, Slloveni. Pas takimit, kryeministri Kurti deklaroi se kishte diskutuar me presidentin Vuçiq lidhur me Procesin e Berlinit, lirinë e lëvizjes dhe njohjen e diplomave, ku ka kërkuar që gjashtë partnerët e Ballkanit perëndimor “të trajtohen si të barabartë”. Presidenti Vuçiq deklaroi se Beogradi do të vazhdonte dialogun me Prishtinën, me theks në themelimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, siç parashihet në Marrëveshjen e parë të parimeve për normalizimin e marrëdhënieve të prillit 2013.

31. Përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian, Lajčák, pati tri vizita në Prishtinë dhe Beograd me qëllim, në mes të tjerash, të inkurajimit të përparimit në zbatimin e marrëveshjeve të arritura më parë dhe në diskutimet aktuale për energjinë; në kërkesat e ndërsjella pronësore dhe financiare; në personat e zhvendosur brenda vendit dhe ata të zhdukur dhe në zhvillimin ekonomik. Ai gjithashtu ka shqyrtuar mundësinë e caktimit të takimit të ardhshëm në nivel udhëheqësish me fokus në arritjen e përparimeve konkrete.

32. Në nivel punues, kryenegociatorët e Prishtinës dhe Beogradit udhëtuan në Bruksel më 16 dhe 17 nëntor 2021, ku u takuan ndaras me përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian. Pas takimit, Beogradi vuri në pah mosgatishmërinë e Prishtinës për të diskutuar më tej zbatimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe, përderisa Prishtina argumentoi se çështja e të drejtave të komuniteteve duhet të përfshihet në “një pako më të gjerë”. Të njëjtit negociatorë u ritakuan më 22 shkurt 2022 në Bruksel, me ç’rast patën takime të ndara me z. Lajčák, të cilat raportohet të kenë pasur përparime të vogla.

33. Më 11 janar 2022, sekretari i shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Antony Blinken, i shkroi kryeministrit Kurti, ku e inkurajon atë që të realizoj zotimet e bëra më parë brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, dhe të angazhohet në negociata me “fokus, kreativitetet dhe urgjencë të nevojshme”. I dërguari special i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin perëndimor, Gabriel Escobar dhe z. Lajčák, së bashku vizituan Prishtinën dhe Beogradin nga 31 janari deri më 4 shkurt 2022 me qëllim të diskutimit të modaliteteve për avancimin e përparimit në dialog dhe të konsultimit me palët e tjera me interes.

34. I dërguari i sapoemëruar special i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore për Ballkanin perëndimor, Sir. Stuart Peach, vizitojë Beogradin dhe Prishtinën nga data 8 deri më 10 shkurt 2022. Në mars 2022, Gjermania



emëroi ish-deputetin e parlamentit gjerman, Manuel Sarrazin, si përfaqësues të saj special për Ballkanin perëndimor.

35. Më 10 dhjetor, përfaqësuesit e 47 organizatave të shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova lëshuan një deklaratë ku i thërrasin autoritetet e Beogradit dhe Prishtinës që të rifillojnë dialogun në mënyrë substanciale dhe të përmbahen nga retorika nxitëse kundër komuniteteve pakicë, të përkrahin masat e ngritjes së besimit me qëllim të bashkimit të komuniteteve dhe që të kenë një debat më të gjerë brenda shoqërive dhe mes tyre lidhur me zgjidhjet dhe prioritetet e dialogut.

## **VI. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet e komuniteteve**

36. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) ka regjistruar 118 kthime vullnetare të anëtarëve të komuniteteve joshumicë, të cilët ishin të zhvendosur brenda Kosovës dhe jashtë saj. Nga të kthyerit, 57 janë femra dhe 61 meshkuj (59 serbë, 19 romë, 10 ashkali, 13 egjiptas dhe 17 shqiptarë). Kjo shifër sjell gjithsej numrin e personave të zhvendosur të komuniteteve joshumicë që kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 në 29.075, ku janë 14.275 femra dhe 14.800 meshkuj (12.577 serbë, 7.746 egjiptas dhe ashkali, 4.047 romë, 1.878 boshnjakë, 1.464 goranë, 1.319 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe 4 imigrimi kroatë). Në Kosovë mbesin 15.683 persona të zhvendosur (7.220 femra dhe 8.463 meshkuj) dhe 69.627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosjen në Ballkanin perëndimor, nga përafërsisht 200.000 persona të zhvendosur nga Kosova që jetojnë në rajon, shumica prej tyre në Serbi.

37. Emigrimi dhe imigrimi në Kosovë vazhduan gjatë periudhës raportuese, me gjithsej 718 imigrantë (631 meshkuj dhe 87 femra), nga të cilët 231 aplikuan për mbrojtje ndërkombëtare (212 meshkuj dhe 19 femra). UNHCR ka siguruar ndihmë juridike falas dhe përkrahje psikologjike për të gjithë azilkërkuesit, si dhe shërbime të përkthimit me gojë dhe përfshirjen e tyre në programin e vaksinimit të Kosovës kundër COVID-19. Organizata ndërkombëtare për migrim (IOM) përkrahu autoritetet e Kosovës në grumbullimin e informatave për imigrantë përmes Matricës së gjurmimit të zhvendosjes. Qendra e re e pranimit dhe regjistrimit është inauguruar në Vranidoll të komunës së Prishtinës për të zgjeruar strukturën ekzistuese të përkrahjes së imigrantëve dhe azilkërkuesve.

38. IOM ka vazhduar me promovimin e kthimit të qëndrueshëm vullnetar dhe me mundësi për reintegrim përmes masave për të kthyerit dhe komunitetet pranuese. Gjatë periudhës raportuese, 21 persona nga Kosova (19 meshkuj dhe 2 femra) u kthyen vullnetarisht nga Belgjika, Kroacia, Holanda dhe Zvicra. IOM u ndihmoi të kthyerve, duke u ofruar trajnime, përkrahje nga fusha e ndërmarrësisë, kujdesit social, banimit dhe nga fusha mjekësore e arsimore.

39. UNHCR vazhdoi përkrahjen e anëtarëve të komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase në marrjen e dokumenteve personale dhe në zgjidhjen e çështjeve të statusit civil për t'ua mundësuar qasjen në shërbime publike. Në kuadër të mbështetjes hyri

edhe ofrimi i ndihmës juridike në përpunimin e regjistrimit civil të tyre dhe lehtësimin e qasjes në arsim, si dhe në kërkimin e të drejtave pronësore e pensionale.

40. Gjatë periudhës raportuese, prapë nuk ka pasur kontribute në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për përkrahje të komuniteteve rome, ashkalike dhe egjiptase të prekura nga helmimi me plumb në Kosovë.

41. Më 24 shtator 2021, Gjykata Kushtetuese e Kosovës lëshoi një deklaratë lidhur me moszbatimin e vendimeve të saj paraprake, duke kërkuar nga qeveria e Kosovës që të zbatojë vendimin e Gjykatës të datës 19 maj 2016 lidhur me regjistrimin e tokës së manastirit të Deçanit. Deklaratën e kanë mirëpritur përfaqësuesit e lartë me seli në Prishtinë, të cilët prapë kërkuan nga qeveria e Kosovës që të veprojë pa vonesa sipas vendimit. Deri në fund të periudhës raportuese, nuk janë raportuar hapa për zbatimin e vendimit gjyqësor.

## **VII. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut**

42. Gjatë periudhës raportuese, zyrat e prokurorisë së Kosovës ngritën disa aktakuza të profilit të lartë për korrupsion. Më 1 tetor 2021, Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ngriti aktakuzë kundër ish-zyrtarit të Ministrisë së Financave dhe një afaristi lidhur me akuzat për vjedhjen e 2 milionë eurove nga Thesari i Kosovës. Më 27 tetor 2021, Gjykata themelore në Prishtinë vërtetoi aktakuzën kundër pesë të dyshuarve, duke përfshirë ish-ministrin e Integritetit Evropian, për akuzat e keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Gjykata e Apelit gjithashtu e ka konfirmuar aktakuzën. Më 18 nëntor 2021, Zyra e Prokurorisë themelore në Gjilan ngriti aktakuzë për kontrabandë dhe vepra të tjera ndaj 73 individëve, duke përfshirë 14 ish-policë të Kosovës në rastin e quajtur Karaçeva. Gjykata themelore e Prishtinës shqiptoi masa të paraburgimit kundër 31 individëve, duke përfshirë zyrtarë komunalë dhe të tjerë, të dyshuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit dhe përfshirje në mashtrim lidhur me subvencionet në bujqësi. Më 22 shkurt 2022, Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ngriti aktakuza kundër 21 këtyre të dyshuarve. Më 14 mars 2022, në një operacion të përmasave të mëdha, policia e Kosovës arrestoi 48 policë dhe 2 doganierë që punonin në pikëkalimet Qafë e Prushit dhe Morinë, në kufirin me Shqipërinë, të cilët dyshoheshin për krim të organizuar, keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar dhe për marrje të ryshfetit, me ç'rast procedurat penale kanë filluar ndaj 68 individëve.

43. Më 17 dhjetor 2021, Departamenti special i Gjykatës së Apelit konfirmoi vendimin e Departamentit special të Gjykatës Themelore të Prishtinës lidhur me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova në mars të vitit 2018, duke vërtetuar aktakuzat për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar kundër ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe dy ish-zyrtarëve të Departamentit për shtetësi, azil dhe migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përkatësisht në Drejtorinë për migrim dhe të huaj në policinë kufitare të Kosovës.

44. Më 24 janar 2022, Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit filloi procedurat në përputhje me Ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik lidhur me shqyrtimin e pasqyrave financiare të disa zyrtarëve

të Listës Serbe, duke përfshirë kryetarin e saj, Goran Rakiq, dhe zëvendëskryetarin e Kuvendit të Kosovës, Sllavko Simiq, për pretendimin e mosraportimit të pasurisë apo të hyrave të pranuar nga institucionet e financuara nga Beogradi.

45. Më 16 shtator 2021, Ministria e Punëve të Brendshme nënshkroi një marrëveshje me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol) lidhur me emërimin e zyrtarit ndërlidhës në Europol dhe krijimin e linjës së sigurt të komunikimit e këmbimit të informatave. Qeveria e Kosovës gjithashtu miratoi një konceptdokument për zhvillimin e procesit të ri të vetingut për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe themeloi grupin punues për hartimin e legjislacionit përkatës. Më 25 shkurt, ministrja e Drejtësisë e Kosovës ia parashtrroi për shqyrtim Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisionit të Venecias) propozimlegjislativ për Këshillin e Evropës, i cili dha mendimin e tij në mesin e marsit 2022. Më 29 dhjetor 2021, qeveria e Kosovës ia parashtrroi Kuvendit të Kosovës propozimligjin mbi byronë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, përmes të cilit do të krijohet koncepti i konfiskimit civil, përveç atij penal. Më 9 mars 2022, qeveria gjithashtu miratoi propozimet për ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Nga ana tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës ngriti shqetësime lidhur me miratimin e shpejtë të propozimndryshimeve, duke theksuar nevojën për konsultime paraprake me të gjitha palët me interes për të siguruar bashkërendimin ndërinstitucional.

46. Gjykatat e Kosovës vazhduan të trajtojnë disa raste të krimeve të pretenduara të luftës. Më 5 tetor 2021, Gjykata themelore në Prishtinë dënoi ish-rezervistin e policisë serbe, Goran Stanishiq, me 20 vjet burg për vrasjen e 13 civilëve në komunën e Lipjanit në vitin 1999. Më 9 nëntor 2021, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës ngriti aktakuzë ndaj një individi për krimet e pretenduara të luftës kundër popullatës civile mes viteve 1998 dhe 1999 në fshatin Bellopojë.

47. Autoritetet gjyqësore të Kosovës vazhduan me ndjekjen penale të individëve të përfshirë në terrorizëm dhe luftëra të huaja. Më 9 tetor 2021, u arrestuan pesë persona si pjesë e grupit militant radikal islamik lidhur me dyshimet se po përgatisnin sulme terroriste në Kosovë, me ç'rast ata u dërguan në paraburgim. Më 19 janar 2022, një gruajë që më parë ishte riatdhesuar nga Republika Arabe e Sirisë, iu shqiptua dënimi me 2 vjet heqje lirie me kusht, ndërsa dy meshkuj janë dënuar me dy vite e gjashtë muaj, përkatësisht me tri vite e tetë muaj burgim, për bashkim me Shtetin Islamik në Irak dhe Levant (ISIL, gjithashtu i njohur si Da'esh).

48. Më 27 tetor 2021, qeveria miratoi Programin e saj për mbrojtjen dhe avancimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut 2021–2025 dhe Planin e veprimit për të 2021–2023 me qëllim të përkrahjes së zbatimit të standardeve drejtpërdrejt të aplikueshme ndërkombëtare dhe regjionale për të drejtat e njeriut sipas Kushtetutës së Kosovës dhe të harmonizimit të kornizës ligjore me Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

49. Duke marrë parasysh incidentet e përsëritura të diskriminimit të personave egjiptas dhe romë, institucionet e Kosovës kanë nënvizuar dështimin në zbatimin e

efektshëm të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Lidhur me këtë, Komisioni Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës organizoi një numër mbledhjesh për shqyrtimin e pengesave në zbatimin e ligjit dhe për mënyrën më të mirë të trajtimit të tyre.

50. Më 22 shtator 2021, qeveria e Kosovës, duke pranuar ndikimin joproporcional të pandemisë COVID-19 ndaj personave me aftësi të kufizuara, miratoi Planin e veprimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2021–2023) brenda kornizës së Strategjisë së Kosovës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013–2023), dhe shpalli vitin 2022 si vit i personave me aftësi të kufizuara.

51. Ministria e Drejtësisë krijoi një grup punues, të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve relevante të Kosovës dhe shoqërisë civile, për hartimin e propozimligjit për themelimin e institutit për dokumentin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë.

52. UNMIK-u vazhdoi me mbështetjen e përpjekjeve për zbardhjen e fatit të 1.620 personave (1.357 meshkuj dhe 263 femra) që ende janë të zhdukur në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999, duke mbajtur kontakte me familje dhe me anëtarët e grupit punues të Beogradit dhe Prishtinës për personat e zhdukur në Kosovë. Derisa çështja e personave të zhdukur është ngritur në diskutime politike brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës, gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur takime të grupit punues.

53. Më 21 dhjetor 2021, autoritetet e Kosovës dhe qeveria e Danimarkës nënshkruan një letër të qëllimit të mirë për dhënien me qira të qelive të burgut për 300 josh tetas të Danimarkës që janë duke vuajtur dënime deri në 10 vjet burg në Danimarkë. Të burgosurit pritet të barten në burgun e Gjilanit. UNMIK-u, në konsultim me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut dhe me institucionet e Kosovës, duke përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit, vazhdon të përcjellë zhvillimet lidhur me mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi.

54. Asociacionet vendore të gazetarëve në Kosovë disa herë kanë ngritur shqetësime për lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes si reagim ndaj sulmeve fizike të gazetarëve dhe sulmeve verbale të politikanëve në media.

55. Më 20 janar 2022, mbi 90 organizata të shoqërisë civile, individë dhe aktivistë i apelian institucioneve të Kosovës, ku kërkuan futjen e martesës së gjinive të njëjta në Kodin Civil. Më 23 shkurt 2022, njëkohësisht me shqyrtimin e amendamenteve në Kodin Civil në Kuvendin e Kosovës, Bashkësia Islame e Kosovës, Dioçeza e Prizrenit- Prishtinës (Kisha Katolike), Kisha Protestante Evangjeliste e Kosovës dhe komuniteti hebre i Kosovës shprehën kundërshtimin e përbashkët, duke shtuar këtu edhe kundërshtimin e shprehur nga kryesuesi i Komisionit Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës ndaj futjes së një dispozite të tillë në Kodin Civil.

56. UNMIK-vazhdoi me ofrimin e shërbimeve për certifikimin e dokumenteve banorëve të Kosovës, ku gjithsej janë përpunuar 2.059 dokumente gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë 843 lidhur me pensionet dhe 1.216 me gjendjen civile. UNMIK-u lehtësoj lëshimin e 24 fletarresteve ndërkombëtare dhe pesë kërkesave për ekstradim të dërguara nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë Penale (INTERPOL) në Kosovë. Misioni gjithashtu hapi 827 raste për hetim brenda bazës së të dhënave të (INTERPOLIT). Duke marrë parasysh numrin e rasteve të trajtuara dhe të mbyllura, aktualisht mbesin 756 raste të hapura lidhur me territorin apo popullin e Kosovës.

### **VIII. Gratë, paqja dhe siguria**

57. Që nga themelimi në vitin 2018, Komisioni qeveritar i Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale lidhur me konfliktin, ka pranuar 1656 aplikacione. Që nga marsi i vitit 2022, 1149 aplikantëve (1098 gra dhe 51 burra) iu dha statusi i të mbijetuarit, ndërsa 229 aplikacione (nga 193 gra dhe 36 burra) u refuzuan. UNMIK-u vazhdon të monitorojë dhe të mbështesë fushatat e ndërgjegjësimit të drejtuara nga Komisioni, për të inkurajuar të mbijetuarit që të aplikojnë për statusin para përfundimit të mandatit të komisionit në vitin 2023.

58. UNMIK-u vazhdoi të avokojë për të drejtat e grave, duke përfshirë ato gra në kushte më të cenueshme. Gjatë fushatës 16-ditore të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore nga 25 nëntori deri më 10 dhjetor 2021, e cila përfshiu gjithsej 132 ngjarje nëpër komunat e Kosovës, UNMIK-u shfaqti një film të prodhuar nga vet Misioni, "Romni", dhe dokumentarin shoqëruar, "Si një grua e vërtetë", duke u fokusuar tek martesat e hershme në komunitetin rom, pasuar me debate dhe diskutime interaktive.

59. Më 26 janar 2022, qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë 2022–2026 për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave dhe Planin e saj shoqëruar të veprimit. Të dy dokumentet janë të harmonizuara me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), e cila u inkorporua në Kushtetutën e Kosovës në shtator të vitit 2020.

60. Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e njëzet e një vjetorit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1325 (2000) për gratë, paqen dhe sigurinë, agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN-Women) organizoi diskutime me institucionet e sigurisë së Kosovës, për rolin e grave në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë. UN-Women dhe Policia e Kosovës publikuan gjithashtu një studim që përshkruan sfidat kryesore me të cilat përballen policia dhe institucionet e

drejtësisë në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe rekomandime për të siguruar praktika policore më të përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore.

61. Më 9 dhjetor të vitit 2021, gjatë një samiti përmes internetit për demokraci të organizuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Presidentja Osmani shprehu përkushtimin e Kosovës për forcimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, si dhe forcimin e rolit të gruas në shoqërinë kosovare, duke theksuar në veçanti luftën kundër dhunës me bazë gjinore. Ajo njoftoi mbi synimin e Kosovës për të mbajtur një samit global për gratë në paqe dhe siguri në vitin 2022.

62. Më 5 janar të vitit 2022, vrasja e supozuar e një gruaje nga partneri i saj në komunën e Skenderajt, provokoi protesta publike për dhunën me bazë gjinore në Kosovë. Autori i dyshuar u arrestua në të njëjtën ditë. Grupet e shoqërisë civile kërkuan që të bëhet më shumë për mbrojtjen e grave. Grupi shumëpalësh gjinor dhe i sigurisë në Kosovë, i kryesuar nga UN-Women dhe i përbërë nga përfaqësues ndërkombëtarë, qeveritarë dhe të shoqërisë civile, u bëri thirrje institucioneve të Kosovës që të hetojnë tërësisht rrethanat e vrasjes dhe të sigurojnë drejtësi.

63. Ndërmjet 25 nëntorit dhe 9 dhjetorit të vitit 2021, UN-Women kreu një studim në mesin e grave deputete të Kuvendit të Kosovës, për dhunën ndaj grave në politikë dhe pengesat për pjesëmarrjen e grave në politikë. Studimi zbuloi se dhuna ndaj grave në politikë ishte e lidhur me përjashtimin, marginalizimin, paternalizmin dhe forma të tjera të diskriminimit, të cilat kontribuan në ndjenjën e pafuqisë tek gratë e angazhuara në partitë politike dhe institucionet e Kosovës.

## **IX. Ndërtimi i besimit, partneriteti dhe bashkëpunimi**

64. UNMIK-u vazhdoi të ndjekë një qasje të përqendruar te njerëzit përmes përqendrimit në ndërtimin e besimit të nxitur nga vendorët të cilët bënin ndryshime. Misioni vazhdoi të punojë me partnerët vendorë për të avancuar agjendën e tij për ndërtimin e besimit, duke promovuar angazhimin e të gjitha komuniteteve përmes platformës në internet për ndërtimin e besimit në Kosovë, promovimin e aktiviteteve me përmbajtje arsimore dhe kulturore dhe rigjallërimin e hapësirave të artit në rajonin e Mitrovicës (një përpjekje bashkëpunuese, ndëretnike në mes të shoqërisë civile nga Mitrovica e Jugut dhe e Veriut), dhe mbështetjen e sipërmarrësisë së të rinjve përmes trajnimeve për zhvillimin e biznesit, mentorimit dhe granteve të vogla. UNMIK-u gjithashtu ka mbështetur fuqizimin ekonomik të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë në rajonin e Mitrovicës, duke ofruar trajnime profesionale në teknologjinë informative dhe shkathësitë gazetareske, përkrahjen e një ndërmarrjeje sociale shumëtnike të rrobaqepësisë përmes një projekti për ndërtimin e besimit të financuar nga UNMIK-u, dhe mbështetjen e orëve të vozitjes për gratë e reja, si dhe trajnimet e realizuara nga organizata joqeveritare “Romtegra”.

65. Si pjesë e avancimit të ndërtimit të besimit ndërmjet komuniteteve dhe ndërmjet njerëzve e institucioneve, UNMIK-u mbështeti iniciativat për të përballuar sfidat e paraqitura nga COVID-19, dhe për të mbështetur rimëkëmbjen pas pandemisë. UNMIK-u siguroi pajisje për të lehtësuar diagnostifikimin e hershëm të

gjendjes respiratore dhe trajtimin e COVID-19 në një qendër mjekësore në Mitrovicën e Jugut dhe në një spital në Mitrovicën e Veriut. UNMIK-u gjithashtu mbështeti përpjekjet për të luftuar dhunën në familje, duke mundësuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet strehimoreve të viktimave të dhunës në familje, organizatave të ndërlidhura të shoqërisë civile dhe institucioneve përkatëse.

66. UNMIK-u vazhdoi të promovojë agjendën për rininë, për paqen dhe sigurinë, duke përfshirë përmes partneritetit të tij me degën e Kosovës të rrjetit ndërkombëtar rinor "YMCA", për të drejtuar një program televiziv të udhëhequr nga të rinjtë "Heronjtë e të rinjve, të bashkuar në diversitet", që paraqet një ekip etnikisht të përzier të të rinjve dhe të rejave që bëjnë ndryshime. Misioni mbështeti riaktivizimin e Observatorit të Prishtinës me temën "Nën një qiell, ndërtimi i besimit të të rinjve përmes astronomisë dhe shkencës", duke i dhënë përparësi përfshirjes së grave të reja nga komunitete të ndryshme, dhe një sërë shkëmbimesh shkencore ndërkomunitare mes të rinjve nga Kosova dhe pjesët e tjera të rajonit. Këto aktivitete synojnë të mbështesin bashkëpunimin ndëretnik ndërmjet të rinjve përmes artit, kulturës, shkencës dhe sportit, si dhe iniciativave mediatike që promovojnë tregime pozitive të bashkëpunimit ndëretnik të të rinjve dhe pjesëmarrjes në çështjet e komunitetit.

67. UNMIK-u vazhdoi të mbështesë integrimin e gjyqësorit dhe administrimin e drejtësisë, veçanërisht në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe angazhimin e përkthyesve dhe bashkëpunëtorëve ligjorë për të ndihmuar në zvogëlimin e mëtejshëm të lëndëve të mbetura pranë Gjykatës themelore të Mitrovicës. Në partneritet me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), u rekrutuan përkthyes dhe interpret gjyqësorë për gjykatën themelore të Prishtinës, dhe u ofrua mbështetje për gjykatën themelore të Prishtinës dhe atë të Ferizajt për të sistematizuar arkivat e tyre dhe dosjet e lëndëve.

68. Qendra për mbështetjen e ndihmës juridike e Institutit të Kosovës për Drejtësi e mbështetur nga UNMIK-u, vazhdoi të ofrojë ndihmë juridike falas për grupet e cenushme për çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, si dhe të drejtat pronësore, të punës dhe të pensionistëve dhe në lëndët strategjike gjyqësore. UNMIK-u gjithashtu mbështeti një organizatë joqeveritare lokale "Inject" në monitorimin e seancave gjyqësore në Prishtinë dhe Prizren për rastet që kanë të bëjnë me pronën, qëndrueshmërinë financiare dhe dhunën në familje. Gjatë periudhës raportuese, "Inject" ka monitoruar mbi 200 seanca gjyqësore dhe ka përkrahur nevojën e qartësisë të kornizave ligjore në lidhje me vlerësimin e kontesteve të pronësisë së përbashkët.

69. UNMIK-u ndërmori disa iniciativa që synojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Kjo përfshinte mbështetjen për edukimin mbi të drejtat e njeriut për të rinjtë, profesionistët ligjorë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, dhe për zyrtarët komunal në rajonin e Mitrovicës, lidhur me trajtimin e shqetësimeve dhe shkeljeve që lidhen me të drejtat e njeriut. Në partneritet me IOM-in, UNMIK-u vazhdoi të promovojë të drejtat gjuhësore në Kosovë dhe mundësitë për mësimin e të dy gjuhëve zyrtare nga të gjithë në Kosovë. Në përpjekjet e tij për të mbështetur komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, Misioni filloi një iniciativë për avancimin e të drejtave për jetë, shëndetësi, arsim dhe një standard adekuat të jetesës

për banorët e mëhallës së romëve në Mitrovicën Jugore. UNMIK-u, në bashkëpunim me UNHCR-në dhe fondacionin Jahjaga, gjithashtu mbështeti zgjerimin e mundësive për krijimin e të ardhurave dhe punësimit për gratë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë.

70. Misioni dhe Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë vazhduan të sigurojnë bashkëpunim dhe bashkërendim përmes kornizës së përbashkët të integruar strategjike, e cila ka lehtësuar drejtimin e përpjekjeve të përbashkëta. Të udhëhequr nga forumi i drejtuesve të lartë të kornizës, grupet e brendshme tematike të punës kanë zhvilluar iniciativa të përbashkëta në fushat prioritare që lidhen me kohezionin social, sundimin e ligjit, barazinë gjinore, të rinjtë dhe të drejtat e njeriut.

71. Në dhjetor të vitit 2021, programi i Kombeve të Bashkuara për vendbanimet e njerëzve (UNHabitat) në partneritet me UNMIK-un filloi një projekt për të matur ndikimin socio-ekonomik të COVID-19 në komunitatet e Kosovës. Projekti që është duke vazhduar ka bërë vlerësimin e ndikimit të pandemisë në 38 komunitatet, përfshirë ndikimin në shoqërinë civile dhe në bizneset. Duke u mbështetur në vlerësimet e mëparshme të kryera nga UNDP-ja, UN-Women dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, iniciativa do të ndihmojë në drejtimin e mbështetjes nga institucionet e qeverisë qendrore dhe palët ndërkombëtare, në përmbushjen e sfidave të rimëkëmbjes dhe zhvillimit afatgjatë në nivel lokal.

72. Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën vazhdoi të mbështesë iniciativat për mbrojtjen e mjedisit dhe nxitjen e një “transformimi të gjelbër” në Kosovë. Në nëntor të vitit 2021, UNDP-ja, vullnetarët e OKB-së dhe OBSH –ja filluan një projekt të mbështetjes së institucioneve të Kosovës për të promovuar planifikim më gjithëpërfshirës, të bazuar në fakte, si dhe monitorimin dhe adresimin e ndikimit të ndotjes së ajrit dhe mbeturinave në shëndet. Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën gjithashtu filloi një fushatë për të inkurajuar angazhimin aktiv në të gjithë shoqërinë kosovare për përshtetimin e tranzicionit drejt një ekonomie me zero ndotje. UN-Habitat krijoi një forum lokal për drejtuesit e komunitetit për klimën dhe organizatat e shoqërisë civile, për të përshtetur partneritetet për veprime klimatike gjithëpërfshirës dhe shumë-nivelëshe.

73. Këshilli për zhvillim të qëndrueshëm i Kuvendit të Kosovës vazhdoi të luaj rolën e tij në avancimin e progresit drejt përmbushjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ). Në këtë drejtim, ky këshill mbajti një seancë dedikuar kësaj çështjeje më 11 shkurt të vitit 2022 për të diskutuar, ndër të tjera, një integrim më efektiv të OZhQ-ve në politikat dhe buxhetet publike.

## **X. Vrojtjet**

74. Ky raport ilustron rëndësinë e vazhdimin të përpjekjeve për të kundërshtuar përdorimin e retorikës përçarëse, për forcimin e kohezionit social dhe për avancimin e dialogut në Kosovë. Për më tepër, pandemia COVID-19 dhe ndikimi i saj disproporcional në komunitete dhe grupe të cënueshme, vazhdojnë të shërbejnë si një përkujtesë se duhet bërë më shumë për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave që mund të paraqiten.



75. Procesi i dialogut i mbështetur nga Bashkimi Evropian mbetet forumi kyç për arritjen e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Më vjen keq që është bërë pak progres dhe inkurajoj të dyja palët që të angazhohen në mënyrë konstruktive drejt arritjes së rezultateve konkrete në dobi të të gjithëve. Procesi i dialogut dhe përpjekjet për normalizim kanë mbështetjen e plotë dhe të qartë të Kombeve të Bashkuara.

76. Në këtë drejtim, mbajtja e një procesi të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës është thelbësor për arritjen e marrëveshjeve të zbatueshme dhe të qëndrueshme. I inkurajoj të dyja palët të sigurojnë pjesëmarrje kuptimplote të një grupi të gjerë akterësh, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë, si dhe akterë të tjerë të shoqërisë civile, dhe të marrin parasysh nevojat dhe pritshmëritë e tyre për procesin e dialogut të mbështetur nga Bashkimi Evropian.

77. Përgëztoj qeverinë e Kosovës dhe Komisionin qendror të zgjedhjeve për mbarëvajtjen e suksesshme të zgjedhjeve lokale në mbarë Kosovën në tetor të vitit 2021. Është e rëndësishme që Kosova të vazhdojë të avancojë përpjekjet për reformën zgjedhore siç përcaktohet në rekomandimet e raporteve të misioneve vëzhguese të zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, dhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, i datës 19 tetor 2021.

78. E ritheksoj thirrjen time për qeverinë e Kosovës që, pa vonesë të mëtejshme, të zbatojë plotësisht vendimin e majit 2016 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për pronën në Manastirin e Deçanit. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm drejt demonstrimit të respektit të qeverisë për sundimin e ligjit dhe rritjes së besimit të njerëzve te institucionet.

79. E mirëpres miratimin e një strategjie pesëvjeçare për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, dhe inkurajoj qeverinë e Kosovës që të vazhdojë të bëjë përpjekje për të luftuar dhunën me bazë gjinore dhe atë në familje. Do të jetë thelbësore që standardet e Konventës së Stambollit të reflektohen edhe në zbatimin e strategjisë, si një hap kyç në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të autorëve.

80. Ripërsëris thirrjet për Prishtinën dhe Beogradin që të rifillojnë bashkëpunimin brenda grupit ekzistues të punës për personat e zhdukur. Grupi i punës më parë kishte arritur rezultate të prekshme në dhënien e përgjigjeve për familjet e të zhdukurve. UNMIK-u do të vazhdojë të mbështesë procesin, duke promovuar një qasje humanitare dhe të bazuar në të drejtat e njeriut. Në këtë kontekst, mirëpres përkushtimin e të dyja palëve për avancimin e këtyre përpjekjeve, të shprehura në procesin e dialogut të përkrahur nga Bashkimi Evropian.

81. U bëj thirrje institucioneve të Kosovës në të gjitha nivelet, organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale, që të vazhdojnë përpjekjet për krijimin e një mjedisi të favorshëm për kthimin dhe reintegrimin e sigurt, dinjitoz dhe të qëndrueshëm të të gjithë personave të zhvendosur brenda vendit dhe të kthyerve.

82. Konstatohet me keqardhje mungesën e vazhdueshme të kontributeve në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara në mbështetje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë. Përsërisht apelin tim për kontribute vullnetare në këtë fond nga shtetet anëtare dhe akterë e organizata të tjera, për të mundësuar mbështetje më efektive për këto komunitete të cënueshme.

83. Unë mirëpres mbështetjen e vazhdueshme të UNMIK-ut, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, në përpjekjet e Kosovës drejt arritjes së objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

84. Falënderoj Përfaqësuesen time të re Speciale, Caroline Ziadeh, dhe të gjithë punonjësit e Misionit, si dhe koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për zhvillim dhe agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara, për punën e tyre bashkëpunuese në sigurimin e vazhdimësisë së operacioneve gjatë pandemisë si dhe për sigurinë dhe shëndetin e personelit. Gjithashtu dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për paraardhësin e saj, z. Zahir Tanin, për përpjekjet e tij të përkushtuara në avancimin e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon, si dhe për udhëheqjen e tij efektive të Misionit.

85. Gjithashtu shpreh mirënjohjen time për partnerët tanë të kamotshëm, KFOR-in, Bashkimin Evropian, Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe të tjerët, për bashkëpunimin e tyre të ngushtë.

## Shtojca I

### **Raporti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 shtator 2021–15 mars 2022**

#### **1. Përmbledhje**

Njësia e Formuar Policore e EULEX-it (NjFP) ka vazhduar bashkëpunimin e saj të rregullt me Forcën e Kosovës (KFOR) në përputhje me sistemin trenivelësh të sigurisë. Në përgjigje të një kërkesë zyrtare të Policisë së Kosovës (PK), më 20 shtator të vitit 2021, EULEX-i vendosi dy ekipe të NjFP-ve si vëzhgues në dy vendkalimet e përbashkëta (VP) në veri të Kosovës gjatë bllokadës së këtyre VP, pas prezantimit nga autoritetet e Kosovës të 'masave të reciprocitetit' ndaj Serbisë në lidhje me njohjen e targave të automjeteve.

Ekspertët e mjekësisë ligjore të Misionit morën pjesë në takimet dypalëshe ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për çështjet mjekoligjore lidhur me punën për personat e zhdukur. Misioni ka ndihmuar Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës (IML) në ekzaminimin e mbetjeve trupore të gjetura në lokacionin Kizhevak në Serbi. Përveç kësaj, EULEX-i ka ndihmuar ekspertët e IML në kryerjen e inspektimit përfundimtar të mbetjeve njerëzore në lidhje me një hetim të udhëhequr më parë nga

Misioni. EULEX-i gjithashtu ofroi mbështetje në përfundimin e aktiviteteve të një vlerësimi të lokacionit në zonën e Zubin Potokut.

Më 16 dhjetor, Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) prezantoi Raportin e tij të monitorimit sistemik dhe tematik të drejtësisë, që mbulon periudhën nga marsi i vitit 2020 deri në tetor të vitit 2021. Është raporti i pestë i tillë i lëshuar nga Misioni që nga viti 2019 dhe i dyti që vihet në dispozicion të publikut. Raporti ofron gjetjet e Misionit në lidhje me aspektet kritike të funksionimit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe përfshin një numër rekomandimesh specifike për autoritetet e Kosovës që synojnë përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

EULEX-i ka mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës (ShKK) duke monitoruar rekrutimin e zyrtarëve të rinj korrektues, duke organizuar trajnime dhe duke ndihmuar në hartimin e rregulloreve të reja. Për më tepër, EULEX-i i kërkoi SHKK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë që prioritet të kenë rekrutimin e stafit të lartë.

Njësia e Misionit për mbështetjen e dialogut vazhdoi të ofrojë këshilla teknike dhe mbështetje për Përfaqësuesin Special të BE-së për dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor (PSBE DBP), në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve (MIK), lirisë së lëvizjes dhe integritet të gjyqësorit.

## **2. Monitorimi**

Përmes njësisë së tij për monitorimin e lëndëve, Misioni vlerësoi funksionimin e PK-së, prokurorisë dhe gjyqësorit në aspektin e pajtueshmërisë procedurale, materiale dhe të ligjit për të drejtat e njeriut. Pavarësisht pandemisë, monitorimi i rasteve ka vazhduar në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë periudhës raportuese. Prania fizike në gjykata dhe takimet me policinë, prokurorinë dhe gjyqtarët u sigurua kurdoherë që ishte e mundur dhe në përputhje me masat kufizuese në fuqi.

EULEX-i publikoi raportin e tij të pestë sistematik dhe tematik të drejtësisë bazuar në monitorimin e 295 rasteve dhe 378 seancave dëgjimore. Misioni identifikoi çështjet sistematike si shqiptimi i shpeshtë i paraburgimit dhe efektet e tij të mundshme ndëshkuese, kohëzgjatja e tepruar e paraburgimit pa aktgjykim përfundimtar, si dhe rritje e numrit të seancave joproduktive. Temat tjera të trajtuara ishin mungesa e audio regjistrimit të proceseve gjyqësore, mangësitë në identifikimin e institucioneve shtetërore si palë të dëmtuara, veçanërisht në rastet e lidhura me korrupsionin, mungesa e në trajtimin e lëndëve të profilit të lartë dhe mospërputhjet në zbatimin e sanksioneve penale. Në aspektin tematik, çështjet e identifikuar kanë të bëjnë me antikorrupsionin, krimet sipas ligjit ndërkombëtar, të drejtat e pronës, privatizimin dhe likuidimin, administrimin e gjykatave, sistemin informativ për menaxhimin e lëndëve, dhunën me bazë gjinore dhe qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19. Misioni ka dhënë rekomandime për të gjitha të gjeturat, të mirëpritura nga ministrja e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës që u zotuan t'i përcjellin këto rekomandime.

Vonesat në gjykimin e disa rasteve të profilit të lartë që përfshijnë të pandehur të shquar mbetën një problem madhor për performancën e përgjithshme të gjyqësorit të Kosovës. Misioni konstatoi se në shumë raste, një numër i konsiderueshëm i seancave janë shtyrë menjëherë pas fillimit, pasi që i/të pandehuri/it apo dëshmitarët nuk respektojnë ftesën e gjykatës dhe nuk paraqiten. Gjykatat shumë rrallë vendosin sanksione për të penguar një sjellje të tillë, duke rezultuar në një numër të madh seancash joproduktive dhe shtyrje të panevojshme të procedurave. Në raport, EULEX-i kërkoi që të forcojë më tej njësinë e hetimeve speciale të PK-së për hetimin e rasteve të korrupsionit dhe të sigurojë bashkëpunim më të ngushtë me Prokurorinë Speciale (PSRK). Në të njëjtën kohë, EULEX-i përshëndeti avancimin e konsiderueshëm të Kosovës prej 17 pozicioneve, krahasuar me vitin 2020, në 'Indeksin e perceptimit të korrupsionit' të Transparency International për vitin 2021, të publikuar në janar.

Misioni përcolli transferimin e paralajmëruar të disa lëndëve, duke përfshirë rastet e mëparshme të EULEX-it, nga departamentet përkatëse për krime të rënda në gjykatat themelore në Departamentin special në Gjykatën themelore të Prishtinës. Këto transferime të paralajmëruara në Departamentin special kanë të bëjnë me raste tashmë në proces gjykimi dhe nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore. Në përgjigje të kërkesave të Misionit për sqarime, KGJK-ja deklaroi se të gjitha rastet e mëparshme të EULEX-it si dhe rastet e tjera të prekura, do të mbeten në departamentet e krimeve të rënda të gjykatave themelore përkatëse. Përjashtimi i vetëm ka të bëjë me Gjykatën themelore të Prishtinës, lëndët e së cilës do t'u transferoheshin gjyqtarëve nga Departamenti special, në cilësinë e gjyqtarëve të Departamentit të krimeve të rënda, për shkak të ngarkesës së tyre të pretenduar më të ulët. Kjo është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë, të gjitha rastet e transferuara do të duhej të rifillojnë pasi t'i caktoheshin gjyqtarit kryesues të ri, duke rritur kështu vonesat në gjykim.

Misioni ka vërejtur disa përparime në mënyrën se si Njësia për hetimin e krimeve të luftës së PK-së (NJHKL) po përdor bazën e të dhënave për krimet e luftës dhe mjetet e saj, të cilat janë ofruar nga Misioni vitin e kaluar së bashku me disa punëtori trajnuese për stafin e PK-së të caktuar për drejtimin e kësaj baze të të dhënave. Për më tepër, në përputhje me sugjerimet e Misionit, NJHKL filloi të hapë rastet e personave të zhdukur ku rrethanat e zhdukjes tregonin për një krim, duke i lidhur ata me hetimet ekzistuese të krimeve të luftës.

Misioni ka ofruar mbështetje për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratën Publike, si dhe për Agjencinë e Regjistrimit Civil në zbatimin e marrëveshjeve teknike për lirinë e 4 lëvizjeve, siç është arritur pajtimi në dialogun Beograd-Prishtinë të mbështetur nga Bashkimi Evropian. Njohja nga autoritetet e Kosovës të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet serbe (certifikatat e lindjes, të martesës dhe vdekjes dhe patentë shoferi), dhe lehtësimi i regjistrimit të automjeteve me targa të Kosovës për pronarët e automjeteve me targa ish-jugosllave ose të ngjashme, janë të një rëndësie të madhe për sigurimin e vërtetë të lirisë së lëvizjes, kryesisht, por jo ekskluzivisht, për popullatën serbe të Kosovës. Siç është theksuar tashmë në periudhën e mëparshme raportuese, EULEX-i ka përcjellë shfuqizimin, në shtator të vitit 2020, të Udhëzimit administrativ që lejon regjistrimin e automjeteve

me targa KS në Kosovë, dhe ka theksuar shqetësimet e tij lidhur me ndikimin e pritur negativ në lirinë e lëvizjes për faktin se tre vendime ministrore nuk ishin vazhduar.

Ngjashëm, është shqetësues fakti që autoritetet e Kosovës ende nuk e kanë vazhduar vlefshmërinë e rregulloreve të tjera, veçanërisht ato që duhet të lejojnë zëvendësimin e patentë shoferëve serbë me ato të Kosovës dhe njohjen nga autoritetet e Kosovës të dokumenteve të lindjes/martësës/vdekjes, të lëshuara nga strukturat paralele serbe, apo zëvendësimin e dokumenteve të tilla me ato të lëshuara nga Kosova. Misioni ka theksuar vazhdimisht se mosvazhdimi i këtyre vendimeve ndikon negativisht në lirinë e lëvizjes.

Misioni u ftua nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) për të marrë pjesë si anëtar zyrtar në grupin e punës për hartimin e procedurave standarde të punës për Njësinë IAP/REP (Informacion i Avancuar i Pasagjerëve/Regjistrimi i Emrit të Pasagjerëve), që së shpejti do të ngrihet në kuadër të Qendrës kombëtare për menaxhimin e kufirit. Misioni për një kohë të gjatë ka bërë thirrje për krijimin e një njësie që do të merret me zbatimin e sistemit IAP/REP, i cili është një hap parësor që Kosova të jetë në përputhje me udhëzimet e BE-së për luftimin e imigrimit të parregullt dhe përmirësimin e kontrollit kufitar.

EULEX-i vazhdoi të mbështesë menaxhmentin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK). Misioni ka monitoruar procesin e rekrutimit për 50 zyrtarë të rinj korrektues dhe të gjeturat ia raportoi me shkrim menaxhmentit të lartë të SHKK-së. SHKK ka hartuar dy rregullore të reja të brendshme për menaxhimin e të burgosurve të kategorizuar dhe për kategorizimin e të burgosurve sipas nivelit të rrezikut, duke përfshirë komentet dhe propozimet e EULEX-it. Megjithatë, Misioni gjithashtu konstatoi se SHKK-ja përballet me mungesë serioze të stafit të lartë, veçanërisht të drejtorëve të objekteve. Kështu, EULEX-i i kërkoi SHKK-së (dhe Ministrisë së Drejtësisë) që të kenë prioritet rekrutimin e personelit të tillë. Mund të vërehet përparim në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të vetëlëndimit dhe vetëvrasjeve në institucionet korrektuese dhe trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Misioni kreu një analizë të plotë të trajtimit të të burgosurve të radikalizuar fetar dhe ndau gjetjet dhe rekomandimet e tij me SHKK-në në një raport të gjerë. Gjetjet kryesore të këtij raporti theksojnë nevojën për programe më të shënjestruara rehabilituese për shkelësit terroristë dhe për të burgosurit në rrezik radikalizimi, për trajnim më të mirë për stafin e SHKK-së dhe për bashkëpunim të strukturuar dhe mekanizma për shkëmbimin e informacionit ndërmjet SHKK-së dhe organeve të tjera, në veçanti Shërbimi Sprovues i Kosovës.

EULEX-i ka mbështetur një trajnim treditör për zyrtarët korrektues që punojnë me të burgosurit me probleme të shëndetit mendor. Punëtorja përfshinte shkëmbim të informacioneve, diskutime dhe ushtrime të ndryshme, dhe u fokusua në identifikimin dhe trajtimin e varësive, formave të ndryshme të problemeve të shëndetit mendor dhe teknikave të kryerjes së intervistave motivuese. Trajnimi u ndoq nga personeli i gjinisë femërore dhe mashkullore që punojnë në tri objekte të SHKK-së, duke përfshirë ato për të mitur dhe të burgosura femra.

KGJK-ja ka shpallur një proces të rekrutimit për 70 bashkëpunëtorë profesionalë të gjykatave për të gjitha gjykatat e Kosovës. Kështu, KGJK-ja themeloi komisionin e punësimit dhe komisionin e auditimit për të kryer procesin e rekrutimit, përkatësisht shqyrtimin e aplikacioneve, si dhe për të dëgjuar ankesat ndaj vendimeve për rekrutim. Rekrutime të tilla janë në përputhje me rekomandimet e EULEX-it të cilat theksojnë mungesën e këtij stafi në gjykatat në mbarë Kosovën. KGJK-ja gjithashtu hapi procedurat e brendshme të konkurrimit për dy pozita në Divizionin e Gjykatës së Apelit (GJA) në Mitrovicë, të cilat ishin të rezervuara për gjyqtarët serbë të Kosovës. Në nëntor, KGJK-ja shpalli një proces përzgjedhjeje për 54 gjyqtarë në nivel të gjykatave themelore në mbarë Kosovën, nga të cilët tetë pozita ishin të rezervuara për gjyqtarët e komunitetit serb.

Këto vendime dhe rekrutime reflektojnë një përmirësim të qartë në mënyrën se si KGJK-ja ka trajtuar mungesën afatgjate të stafit të kualifikuar në gjyqësor në mbarë Kosovën, dhe në veçanti në Gjykatën themelore dhe Divizionin e GJA në Mitrovicë. Mirëpo, Misioni vërejti me shqetësim se zgjedhja e një gjyqtari serb të Kosovës në KGJK nuk mund të miratohej. Nga 13 anëtarët e KGJK-së, disa duhet të zgjedhen nga Kuvendi, duke përfshirë dy serbë të Kosovës, prej të cilëve të paktën njëri duhet të jetë gjyqtar. Dy gjyqtarë aplikuan për këtë pozitë, por asnjëri prej tyre nuk u zgjodh, gjë që do të bëjë të nevojshme përsëritjen e procesit. Që një kandidat serb i Kosovës të zgjidhet, ai duhet të marrë shumicën e votave nga përfaqësuesit e serbëve në Kuvendin e Kosovës (kjo vlen edhe për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera). Megjithatë, përfaqësuesit serbë të Kosovës bojkotuan votimin dhe refuzuan të mbështesin dy kandidatët. Kjo ilustron vështirësinë për të siguruar pranimin nga komuniteti serb në këtë proces.

Nuk është arritur asnjë përparim sa i përket përbërjes së paneleve në Departamentin special të GJA në Prishtinë. Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013 dhe Marrëveshja e Drejtësisë kërkojnë që panelet shqyrtuese me shumicë serbe duhet të gjykojnë rastet me origjinë nga komunat me shumicë serbe, megjithatë asnjë panel i tillë nuk është themeluar dhe themelimi i tyre as nuk ishte paraparë në planet e punës së GJA për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Nën udhëheqjen politike të Përfaqësuesit Special për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor dhe në bashkëpunim të ngushtë me Shefin e Zyrës së BE-së/PSBE, Misioni në vazhdimësi ka avokuar që ky vendim të ndryshohet, por deri më tani pa sukses. EULEX-i është i shqetësuar për planin vjetor të punës të GJA-së për vitin 2022. Plani i punës nuk përmbushi dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen e Parë të Brukselit në lidhje me përbërjen e paneleve në Departamentin special të GJA-së, i cili merret ekskluzivisht me rastet e PSRK-së. Përderisa panelet me shumicë serbe janë paraparë të merren me të gjitha rastet me origjinë nga komunat me shumicë serbe, plani i ri i punës e zbatoi këtë parim për të gjitha departamentet e GJA, me përjashtim të Departamentit special. Edhe pse nuk ishte në përputhje me Marrëveshjen, KGJK-ja e miratoi planin e punës më 27 janar. Misioni do të vazhdojë të monitorojë nga afër këto zhvillime të ndërlydhura.

Misioni, me kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, ka monitoruar testin e parë dhe të dytin me shkrim për kandidatët për prokurorë të rinj të prokurorive të shtetit. Fillimisht kanë aplikuar 362 kandidatë dhe në testin e parë janë paraqitur 277

kandidatë. Në raundin e dytë u testuan gjithsej 180 kandidatë, prej të cilëve 62 gra dhe një nga komunitetet joshumicë. Kjo do të thotë se pothuajse 65 për qind e kaluan testin e parë me shkrim i cili u mbajt më 21 nëntor të vitit 2021. Për kandidatin nga komuniteti jo-shumicë u ofruan shërbime të përkthimit. Misioni, po ashtu me kërkesë të KGJK-së, ka monitoruar edhe testin e parë edhe atë të dytë me shkrim për kandidatët për 54 gjyqtarë të rinj në gjykatat themelore. Numri fillestar i aplikacioneve ishte më shumë se 500, por pas kontrolleve paraprake dhe eliminimit të kandidatëve të pakualifikuar, numri i aplikantëve që morën pjesë në raundin e parë të provimit më 16 janar 2022 ishte 494. Nga 494 pjesëmarrës, 163 kandidatë, duke përfshirë tre serbë të Kosovës, morën pjesë në dy testet me shkrim të fazës së dytë më 6 shkurt. Po ashtu, Misioni ka monitoruar edhe testimin me shkrim të rreth 300 kandidatëve të cilët iu nënshtruan testit me shkrim për provimin e jurisprudencës. Në mesin e tyre 11 ishin serbë. Asnjë nga kandidatët serbë nuk e kaloi testin. Mungesa e personelit të kualifikuar serb në Kosovë mund të ndikojë në performancën e shumë institucioneve gjyqësore në të ardhmen e afërt.

Misioni vazhdoi të monitorojë procedurat penale kundër shtatë shtetasve të Kosovës të cilët ishin kthyer nga Siria në korrik të vitit 2021, dhe të cilët dyshoheshin se kishin marrë pjesë në aktivitete terroriste. Deri në fund të dhjetorit, u ngritën aktakuza kundër të gjithëve (gjashtë burra dhe një grua), dhe Misioni vërejti se gjykimi kishte përparuar në mënyrë efektive dhe efikase. Në janar u shpallën tre dënime (përfshirë një kundër të pandehurës grua). Misioni vërejti se të gjitha këto dënime ishin të ulëta në krahasim me dënimet në vendet e BE-së për akuza për terrorizëm.

Misioni ka realizuar tri punëtori në bashkëpunim me Prokurorinë themelore të Mitrovicës dhe Akademinë e Drejtësisë së Kosovës, për të forcuar bashkëpunimin e punës së prokurorëve shqiptarë dhe serbë dhe akterëve të tjerë të drejtësisë. Punëtoritë u fokusuan në arritjet dhe sfidat në rajonin e Mitrovicës, duke përfshirë modalitetet për të unifikuar praktikat e përditshme në Njësinë për të mitur në aplikimin e Kodit të ri të drejtësisë për të mitur.

Përmes një projekti të përbashkët të vazhdueshëm, EULEX-i dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizuan një punëtori mbi konceptet kryesore të procedurave gjyqësore dhe monitorimit të gjykimeve për 20 vëzhgues të rinj laik, të cilët pritet të monitorojnë rreth 500 seanca penale në mbarë Kosovën. Këta monitorues, të cilët nuk kanë kualifikim ligjor, janë përzgjedhur në bazë të një sërë kriteresh, duke përfshirë gjininë, përkatësinë etnike, moshën, arsimin dhe profesionin. Në kuadër të të njëjtit projekt, çdo vëzhgues laik do të ndjekë gjithsej 25 seanca të tilla. Misioni hartoi një udhërrëfyes për krijimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e veprave të dhunës seksuale, e cila do të ndihmojë qeverinë në përfshirjen e kërkesave të nenit 25 të Konventës së Stambollit. Më 26 janar, Kosova miratoi Strategjinë e re kombëtare dhe Planin e veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, në të cilën Misioni kontribuoi duke marrë pjesë në hartimin dhe rishikimin.

Misioni filloi aktivitetet e tij në kuadër të “16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore” përmes një fushate ndërgjegjësimi që synon trajtimin e lidhjes ndërmjet të drejtave pronësore dhe dhunës në familje.

EULEX-i mbajti tryezën e parë të rrumbullakët në serinë e dialogëve të trashëgimisë së EULEX-it, me qëllim të nënvizimit të kontributit të Misionit për sundimin e ligjit në Kosovë, me një diskutim mbi bashkëpunimin ndërkombëtar policor.

### 3. Operacionet

Mekanizmi përgjegjës i sigurisë trenivelëshe në Kosovë përbëhet nga PK-ja si reaguesi i parë i sigurisë, Misioni si i dyti dhe KFOR-i si i treti. Misioni vazhdoi të ofrojë mbështetje për PK-në në aftësinë e kontrollit të turmës dhe trazirave përmes këshillave dhe sesioneve të përbashkëta të trajnimit, dhe vazhdon të jetë i gatshëm për të ndihmuar në sigurimin e rendit publik.

Në mesin e shtatorit 2021, një vendim i autoriteteve të Kosovës për të mos vazhduar një dispozitë të përfshirë në Marrëveshjen me Serbinë për lirinë e lëvizjes, të përkrahur nga BE-ja në lidhje me vlefshmërinë e targave të caktuara të regjistrimit të automjeteve, shkaktoi një gjendje serioze pa rrugëdalje midis Kosovës dhe Serbisë. Mosvazhdimi i njëanshëm i kësaj dispozite nga Qeveria e Kosovës ka rezultuar që mijëra automjete të mos kenë më targa të vlefshme në mbarë Kosovën, veçanërisht në rajonin e veriut me shumicë serbe. Kjo nga ana tjetër shkaktoi një reagim të ashpër të popullatës lokale serbe të Kosovës dhe politikanëve, të mbështetur nga Beogradi. Vendosja e njërive speciale të Policisë së Kosovës (PK) në veri për të ndihmuar në zbatimin e kësaj mase, çoi në bllokada nga serbët e Kosovës të rrugëve kryesore për në dy vendkalimet e përbashkëta kufitare në veri të Kosovës, Rudnicë/Jarinje (Porta 1) dhe Brnjak/Tabalije (Porta 31). Njësia e Policisë së Kosovës e formuar nga EULEX-i (NjFP) u vendos në këtë rajon për të monitoruar situatën në dy vendkalimet e përbashkëta kufitare, në përputhje me rolin e mandatuar të Misionit si reagues i dytë i sigurisë në Kosovë. Që atëherë, ekipet e NjFP-së kanë monitoruar nga afër situatën në afërsi të dy vendkalimeve të përbashkëta kufitare. Gjatë gjithë angazhimit të tij në terren, Misioni ka mbajtur bashkëpunim të ngushtë me PK-në dhe KFOR-in në kuadër të sistemit trenivelësh përgjegjës të sigurisë. Mbledhja dhe vlerësimi i informacioneve përkatëse në kohë reale nga ana e Misionit, ka qenë i rëndësishëm në mbajtjen e familjes së BE-së në nivel lokal dhe në Bruksel të informuar për zhvillimin e situatës në terren në çdo kohë.

Kriza u qetësua kur më 30 shtator 2021 në Bruksel, në kuadër të Dialogut të përkrahur nga BE-ja, u arrit një marrëveshje ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për tërheqjen e policisë speciale në veri dhe vendosjen e KFOR-it për dy javë, largimin të bllokadave në rrugë dhe arritjen e marrëveshjes për një regjim të përkohshëm që përfshin aplikimin e ngjitësve që mbulojnë simbole të caktuara në targat përkatëse.

Situata ka treguar në vazhdimësi se është e nevojshme që EULEX-i të jetë i gatshëm dhe plotësisht i aftë për të vepruar dhe ruajtur rolin e tij si reagues i dytë i sigurisë, në koordinim me dy reaguesit e tjerë të sigurisë.

EULEX-i ka mbështetur Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës (IML) në punën e tij për personat e zhdukur. Ekspertët e mjekësisë ligjore të Misionit morën pjesë në takimet dypalëshe ndërmjet delegacioneve të Prishtinës dhe Beogradit për



çështje të mjekësisë ligjore lidhur me këtë punë. Ekipi asistoi gjithashtu ekspertët e IML në ekzaminimin e mbetjeve trupore të shtatë personave të zhdukur të gjetur në lokacionin Kizhevak në Serbi. Eshtrat e pjesëshme shtesë të gjetura në Kizhevak u rishoqëruan me dy individë të identifikuar më parë. Me përfundimin e identifikimit dhe ekzaminimit, eshtrat e të gjithë këtyre personave iu dorëzuan familjeve të tyre për t'u rivarrosur. Eksperti mjekoligjor i Misionit ka ndihmuar gjithashtu ekspertët e IML në kryerjen e inspektimit përfundimtar të mbetjeve njerëzore në lidhje me një hetim të udhëhequr më parë nga Misioni. Mbetjet trupore të inspektuara, së bashku me mbetjet e dy personave të tjerë të zhdukur nga konflikti i Kosovës, të gjithë serbë të Kosovës, iu dorëzuan përfaqësuesve të Komisionit të Qeverisë së Serbisë për persona të zhdukur dhe u kthyen në Serbi. EULEX-i gjithashtu ofroi mbështetje në përfundimin e aktiviteteve për vlerësimin e një lokacioni në zonën e Zubin Potokut.

Misioni mbështeti IML në organizimin e një punëtorie mbi dhunën seksuale, provat biologjike dhe rëndësinë e tyre në procedurat penale. Kjo punëtori ishte hapi i parë në të cilën EULEX-i mbështeti IML-në dhe Ministrinë e Drejtësisë, në krijimin e protokollit shtetëror të Kosovës për rastet e dhunës seksuale, për të siguruar që të mbijetuarve të dhunës seksuale t'u ofrohen shërbimet efektive dhe ndihma që u nevojitet.

EULEX-i ka vazhduar mbështetjen për PK-në në bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Interpolit, EULEX-i ndihmoi shkëmbimin e informacionit ndërmjet Njësisë koordinuese të PK-së për zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar dhe byrove qendrore kombëtare të Interpolit nën ombrellën e UNMIK-ut. Misioni gjithashtu ndihmoi shkëmbimin e informacionit ndërmjet Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol) dhe PK-së për hetimet e krimeve të rënda përmes Zyrës ndërlidhëse suedeze të Europolit, si dhe ndërmjet PK-së dhe autoriteteve serbe (në përputhje me një protokoll ndërmjet Misionit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë). Misioni vërejti përmirësime në shkëmbimin e informacioneve ndërmjet shërbimeve policore të Kosovës dhe Serbisë përmes protokollit të përkrahur nga EULEX, i cili u trefishua në vitin 2021.

Misioni vazhdoi të mbështesë Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

## **Shtojca II**

### **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Më 15 shtator 2021, në fund të periudhës së mëparshme raportuese, rasti kundër z. Salih Mustafës ishte i pari pranë Dhomave të Specializuara (DhS) që filloi procedurat gjyqësore. Z. Mustafa akuzohet për katër pika të akuzës për krime lufte – ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje – të kryera nga disa anëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër personave të ndaluar në kompleksin e paraburgimit në Zllash të Kosovës. Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e

përfundoi lëndën e saj më 4 shkurt të vitit 2022 pasi thirri 13 dëshmitarë për të dëshmuar. Mbrojtja ka paraqitur mocion për hudhjen e akuzave ndaj të akuzuarve. Më 23 shkurt 2022, paneli e refuzoi mocionin. Gjyqi në këtë rast do të vazhdojë më 8 mars të vitit 2022 me konferencën përgatitore të mbrojtjes.

Rasti i dytë për të cilin do të vazhdojë gjykimi pranë DhS është rasti kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinajt, që filloi me deklaratën fillestare të paraqitur nga Prokurori i Specializuar më 7 tetor të vitit 2021. Ky është rasti i parë pranë DhS që mbylli fazën e dëshmimit në procedurë gjyqësore.

Z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen me dy pika të veprave penale kundër rendit publik – pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare – dhe katër pika të veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike – kanosje gjatë procedurës penale, hakmarrje dhe dy pika të shkeljes së fshehtësisë së procedurës.

ZPS zyrtarisht e mbylli rastin e saj më 10 nëntor të vitit 2021. Më 2 shkurt të vitit 2022, pasi thirri 10 dëshmitarë për të dëshmuar, mbrojtja e Haradinajt dhe e Gucati zyrtarisht i mbyllën rastet e tyre. Më 3 shkurt, trupi gjykues, ndër të tjera, mbylli procedurën e provave në këtë rast. Të dy palët dorëzuan përmbledhjet e tyre përfundimtare të gjykimit më 3 mars të vitit 2022 dhe dhanë deklaratat përfundimtare, përgjigjet dhe komentet e tyre për këtë nga 14 -17 marsi i vitit 2022.

Procedurat paraprake në lëndët kundër zotërinjve Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe z. Pjetër Shala janë duke vazhduar. ZPS e dorëzoi përmbledhjen e saj paraprake në lëndën Thaçi dhe të tjerët më 17 dhjetor 2021. Të akuzuarit në këtë rast akuzohen për gjashtë pika të akuzës për krime kundër njerëzimit – përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje dhe zhdukje me forcë të personave – dhe katër pika të akuzës për krime lufte – arrestim të paligjshëm ose arbitrar dhe paraburgim, trajtim mizor, torturë dhe vrasje.

Në rastin kundër z. Pjetër Shalës, i cili akuzohet për katër pika të akuzës për krime lufte – paraburgim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje, ZPS dorëzoi përmbledhjen e saj paraprake më 28 janar 2022. Edhe në këtë rast procedurat paraprake janë duke vazhduar.

Kryetari, gjyqtari i procedurës paraprake, trupat gjykuese dhe kolegjet e Gjykatës së apelit kanë lëshuar 427 urdhra dhe vendime gjatë periudhës raportuese. Janë mbajtur gjashtë seanca para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe 58 seanca para dy trupave gjykuese. Seancat u ndoqën nga palët, me prani fizike dhe përmes video-konferencës.

Pas rifillimit të vizitave personale nga familja e ngushtë e tetë të burgosurve të DhS në mesin e korrikut të vitit 2021, vizitat u zgjeruan për të përfshirë anëtarë të tjerë të familjes dhe vizitorë të tjerë në shtator të vitit 2021. Ndërsa vizitat personale u ndërprejnë për disa javë në fund të nëntorit 2022 për shkak të situatës me koronavirus në shtetin pritës, gjatë periudhës raportuese u realizuan gjithsej 198 vizita në ambientet e paraburgimit të DhS.

Në shtator dhe tetor të vitit 2021, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe Ombudspersoni i DhS, kryen vizita në objektet e paraburgimit të DhS, në përputhje me kornizën ligjore të DhS.

Në janar të vitit 2022, në bazë të një vendimi të një gjyqtari të procedurës paraprake, DhS mundësuan vizitën për në Kosovë të një të paraburgosuri për arsye humanitare, vizita e tretë e tillë deri më sot.

Më 27 janar të vitit 2022, sekretari caktoi avokatin e viktimave për të përfaqësuar viktimat pjesëmarrëse në rastin kundër z. Shalës. Deri në mes të shkurtit, ishin pranuar 29 viktima pjesëmarrëse në tre nga katër rastet pranë DhS, një në rastin kundër z. Shalës, tetë në rastin kundër z. Mustafës dhe 20 në rastin kundër z. Thaçit e të tjerëve. Lista e disponueshme për publikun e avokatëve përmban 219 persona të kualifikuar për të punuar pranë DhS, nga të cilët 107 janë të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat.

Përderisa aktivitetet informuese në terren të DhS janë kryer kryesisht në internet gjatë gjithë periudhës raportuese, Presidentja dhe Sekretari udhëtuan në Kosovë nga 6 deri më 9 shtator 2021, gjatë së cilës kohe ata morën pjesë në dy ngjarje informuese me shoqërinë civile, me mediat dhe OJQ-të, u takuan me anëtarë të komunitetit diplomatik, atij ndërkombëtar dhe vendor, dhe dhanë intervista në media. Në përgjigje të reagimeve të marra nga përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë vizitës, DhS filloi transmetimin e seancave dëgjimore publike në kanalën e saj në YouTube dhe mban konferenca javore për mediat në internet, gjatë të cilave ofrohen përditësime mbi procedurat, si dhe hapi llogarinë e vet tregjuhëshe në Twitter.

Më 27 tetor 2021, Presidentja u paraqit personalisht përpara Komitetit politik dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian (BE) në Bruksel, gjatë të cilit ajo informoi shtetet anëtare të BE-së mbi aktivitetet gjyqësore të DhS dhe iu përgjigj pyetjeve të parashtruara.

Më 25 nëntor 2021, Presidentja, Sekretari dhe Prokurori i Specializuar ofruan informacione të përditësuara për shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese me qendër në Hagë, nëpërmjet video-konferencës, mbi punën e DhS dhe ZPS, si pjesë e konferencës së tyre vjetore për komunitetin diplomatik.

ZPS ka qenë vazhdimisht e angazhuar me zbulimin e provave dhe materialeve që posedon, siç përcaktohet në Rregulloren e punës dhe provave të DhS. Ajo ka refuzuar kërkesat për lirim të përkohshëm, duke argumentuar në një seri dosjesh se ekzistonte një rrezik shumë real që, nëse lirohej, i akuzuari do të pengonte procedurat gjyqësore dhe do të ndërhynte tek dëshmitarët.

ZPS vazhdoi të intervistonte dëshmitarët dhe të dyshuarit si në Hagë ashtu edhe në Prishtinë, të shqyrtonte provat dokumentare të mbledhura gjatë hetimit dhe përgatitjen e tyre për qëllime të zbulimit, dhe ka punuar me autoritetet përkatëse për të siguruar që dokumentet të aprovohen për përdorim në gjykatë dhe që dëshmitarët të lejohen për të dëshmuar në gjykatë. ZPS vazhdon të kërkojë angazhimin dhe mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve individuale në këto dhe të gjitha aktivitetet tjera.

### Shtojca III

**Përbërja dhe numri i komponentës policore të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**  
(deri më 15 mars 2022)

<i>Shteti</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Gjithsej</i>
Austria	1	-	1
Gjermania	2	1	2
Finlanda	1	1	1
Sllovenia		1	1
Rusia	-	1	2
Hungaria		1	1
Ukraina		1	1
Mbretëria e Bashkuar			1
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b><i>4</i></b>	<b><i>6</i></b>	<b><i>10</i></b>

**Përbërja dhe numri i komponentës ndërlidhëse ushtarake e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë**  
(deri më 15 mars 2022)

<i>Shteti</i>	<i>Gra</i>	<i>Burra</i>	<i>Gjithsej</i>
---------------	------------	--------------	-----------------

Republika Çeke	-	2	2
Polonia	-	1	1
Republika e Moldavisë	-	1	1
Rumania	-	1	1
Turqia	1	-	1
Ukraina	1	1	2
<b><i>Gjithsej</i></b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>8</b>



